

19/06/03

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

Seanca Plenare
Seanca nr.2003/18
Prishtinë,më 19 qershor 2003,në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit,salla plenare.

PROCES VERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Fatmir Sejdiu,anëtar i Kryesisë.
Kryesusi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 91 deputetë dhe shpalli të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance,si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për produktet dhe pajisjet medicinale-3003/17;
3. Shqyrtimi i raportit për gjendjen në Koorporatën Energetike të Kosovës;
4. Parashtrimi i pyetjeve dhe
5. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare që duhet të mbahet më 26 qershor 2003.

Kryesuesi propozoi që pika e dytë e rendit të ditës,të shtyhet për seancën e ardhshme,ngase mungonte ministri i shëndëtësisë që duhej ta arsyetonte P/ligjin para deputetëve.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.

Nuk pati vërejtje në procesverbalin e seancës së mëparshme dhe ai u miratua.

2. Shqyrtimi i Raportit për gjendjen në Korporaten Energetike të Kosovës.

Kryesuesi e ftoi kryetarin e Komisionit për Tregti dhe Industri që të paraqes raportin lidhur me këtë çështje.

Bajrush Xhemajli:- Kuvendi i Kosovës e ka ngarkuar Komisionin për Tregti dhe Industri që ta hulumtojë gjendjen në Korporatën Energetike të Kosovës dhe të paraqes raport për këtë çështje.

Komisioni formoi grupin e punës prej pesë anëtarësh i cili gjatë hulumtimit të gjendjes në KEK ka zhvilluar biseda të drejtëpërdrejta me udhëheqësin e KEK-ut dhe shfrytëzoi raportet, analizat dhe informata e tyre.

Vizitoi minieren e Mihjes Sipërfaqësore të Mireshit dhe të Bardhit, ka shfrytëzuar materialet nga Ministria për Shërbime Publike , Ministria për Tregti dhe Industri, Oda Ekonomike e Kosovës si dhe Sindikata e Pavarur Energetike të Kosovës, në bazë të së cilave hartoi këtë raport .

Problemet e mëdha që e ngarkojnë gjendjën në KEK janë të natyrës objektive dhe subjektive .

Problemet objektive janë trashiguar kryesisht nga dëmet që i ka bërë egërsira e pushtuesit: Eksplativi është bërë duke mos i respektuar rregullat përmihjen e djerrinës ; Stabilimentet nuk janë mirëmbajtur si duhet ; Kapacitetet e KEK-ut janë shfrytëzuar në mënyrë të pamëshirshme për prodhimin e energjisë elektrike, pa marrë parasysh nevojat për një prodhim stabil dhe të rregullë.

Kapacitetet e termocentraleve janë 1.478 megavat, por ato nuk mund të shfrytëzohen as përafërsisht për shkak të amortizimit tejet të madh të stabilimenteve të tyre , sidomos në termocentralin “Kosova A” që njëherit është ndotësi më i madh i ambientit .

Problemet subjektive: Faktori njeri është ai i cili ka bërë që KEK-u të jetë në këtë gjendje të rëndë .

KEK-u ende nuk e ka të rregulluar statusin e vetë juridik,gjë që e pengon funksionin normal të tij .KEK-u aktualisht mbikqyret nga z.Stejner ; nga përfaqësuesi i shtyllës së katërt të UNMIK-ut ; nga këshilli mbikqyrs i KEK-ut; dhe nga përfaqësuesi i AKM-së.

Rezultatet e KEK-ut janë tejet të dobëta ngase organet menaxhuese nuk i harmonizojnë aktivitetet e tyre .

Stafi menaxhues vendor nuk ka çasje në investimet në KEK ,kurse stafi ndërkombëtar thotë se në KEK janë investuar rreth 500 miljon dollarë, por pas regjistrimit të mjeteve themelore të investuara ne KEK është konstatuar se vetëm një e treta e mjeteve është investuar .

Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar nuk ëhtë realizuar asnjnë remont i mirfilltë .

Intervmenimet në blloqet e termocentraleve janë bërë ad hoc, vetëm pas prishjeve që kanë qenë të shpeshta .Gjendjen e ka keqësuar sidomos djegëja e bllokut B1 pas goditjës së rrufesë në KEK.Është shqetësuese mospërgjegjësia pas gjithë atyre n-dodhive .Sipas

analizave për rrëshqitjen e dheut në minieren e Bardhit ,pesha e djerrinës e pahequr ishte njëra nga shkaqet e fatkesësisë. Për të gjitha këto që kanë ndodhur në KEK , askush nuk është marrë në përgjegjësi.

Se rrufeja e ka goditur termocentralin “Kosova B”, askush nuk e konteston, por Komisioni ka konstatuar që për dëmët e mëdha që janë shkaktuar në atë rast fajtor është faktori njeri.

Shqetësim tjetër , tepër i madh është se gjysma e rrymës së prodhuar nuk është e fakturuar dhe as që dihet se ku shkon.Kurse gjysma e rrymës së fakturuar nuk inkasohet çka nënkupton se paguhet vetëm një e katërta e rrymës së prodhuar.

Përgjegjësit e KEK-ut rrugdalje nga kjo gjendje tepër e rëndë e shohin në zbatimin e projektit “ KEK-PO” .Ky projekt mund të jetë i realizueshëm vetëm nëse e ka përkrahjen e qytetarëve dhe të institucioneve të Qeverisë së Kosovës.

Fakti se rrymë nuk ka, duhet ta shqetësojnë çdo kend në Kosovë ngase pa te nuk ka zhvillim në asnjë fushë tjetër.

Janë të gjitha parakushtet për të pasur rrymë të mjaftueshme për kohën e ardhshme, nga se thengilli i Kosovës – linjiti ka rezerva tepër të mëdha. Në bazë të hulumtimeve gjeologjike në bazenin e Kosovës ekzistonjë 13.8 miljardë tonë thëngjill që mundëson prodhim të lartë të energjisë elektrike më një çmim konkures në krahasim me alternativat në rajon .Termocentralet bërthamore në rajon në të ardhmen do të mbyllen njëra pas tjetrës, kështu që kërkesat për energji në rajon do të shtohen .Prandaj, duhet ta hartojmë një strategji jo vetëm për prodhimin e rrymës për nëvojat e brendshme por për eksport të saj.

Për të dalur nga kjo gjendje ,Komisioni i ka hartuar rekomandimet përkatëse që do t'i plotësoi ato pas debatit të zhvilluar parlamentar dhe do t'ia paraqes Kuvendit për miratim, përfundoi kryetari i Komisionit .

Kryesuesi hapi debatin lidhur me këtë çështje .

Opinionet , vërejtëjet dhe sugjerimet lidhur me gjendjen në KEK i dhanë edhe këta deputetët: Sabri Hamiti , Berat Luzha , Ramush Haradinaj, Oliver Ivanovic , Gani Koci , Haki Shatri, Millovan Jovanovic, Gani Prekopuca, Fatmir Rexhepi, Hasan Meta , Xhezair Murati, Sylejman Qerkezi , Ali Sadriu dhe Hydajet Hyseni që i janë bashkangjitur stenogramit.

Kryesuesi dha një pauzë të seancës gjatë së cilës Komisioni për Tregti dhe Industri në bashkpunim më shefat e grupave parlamentare ,në bazë të debatit parlamentar për këtë çështje , duhej ti Hartonin rekomandimet që duhej t'i miratonte Kuvendi .

Kryesuesi e ftoi kryetarin e Komisionit për Tregti dhe Industri që t'i paraqesë rekomandimet e harmonizuara gjatë pauzës për gjendjen në KEK.

Bajrush Xhemajli tha se Komisioni për Tregti dhe Industri në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare dhe në bazë të diskutimeve të zhvilluara në këtë seancë për gjendjen në KEK,i propozon Kuvendit këto

R E K O M A N D I M E:

1. Të formohet Komisioni parlamentar për energjetikë;
2. Të nxirren ligjet për veprimtarinë e KEK-ut:Ligji për energjetikë,Ligji për minierat,Ligji për kërkime gjeologjike dhe Ligji për organin e rregullatorit;
3. Qeveria e Kosovës,sa më shpejt të t'i marrë përgjegjësit në fushën e energjetikës dhe të formohet Ministria për Energjetikë;
4. Të rishqyrtohet ristrukturimi i KEK-ut,në mënyrë që të bëhet profitabil dhe konkurent në tregun rajonal të energjetikës derisa të nxirren ligjet përkatëse;
5. KEK-u të anëtarësohet si entitet i veçantë në institucionet e sistemit elektroenergjetik të Evropës Jugëlindore;
6. Të përkrahët strategja e ndërtimit të kapacitetve të reja energjetike;
7. Të ndërtohet linja ndërlidhëse 400 KW në mes të Kosovës dhe Shqipërisë;
8. Të përkrahet fuqishëm strategja e kuadrove vendëse,në të gjitha nivelet,ta udhëheqin KEK-un,kurse kuadrot ndërkombëtare të marrin rolin e këshilldhënësve;
9. Të përkrahet projektu “KEK-PO”për rritje të efektit veprues dhe financiar dhe
- 10.Kuvendi ta autorizojë Qendrën për Hulumtime Finaciare-FIU,për hulumtimin e keqëpërdorimeve eventuale në KEK.

Oliver Ivanoviq tha se si anëtar i Grupit që ka hartuar këto rekomandime,e ka veçuar mendimin e tij dhe paraqiti rekomandimet e veta,si vijon:

1. Puna e gjertanisshme në KEK,nuk është në nivelin e duhur teknik dhe teknologjik,që si pasojë e përditëshme janë ndalesat e energjisë elektrike;
2. Mostransparenca absolute në punën dhe shpenzimin e mjeteve të donacioneve dhe të buxhetit të Kosovës,që është shumë me rëndësi,ka mundësuar keqëpërdorimin dhe korruptionin që ka sjellë dëme të mëdha;
3. Të përcaktohet përgjegjësia e udhëheqësisë së tanishme për gjendjen aktuale në termoelektrana;
4. Të mirret vendim për lirimin e përkohshëm të pagesës së energjisë elektrike të kategorive sociale të irrezikuara si dh të peronave të zhvendosur;
5. Të merret vendim për kthimin e punëtorëve dhe të inzhenjerëve serb në termoelektrana që mëherët kanë punuar në to e që tani jetojnë në Kosovë ose janë perona të shvendosur;
6. Të formohet Komisioni parlamentar,ad hoc, që në bashkëpunim me përfaqësuesit e ministrike,të Qeverisë dhe të UNMIK-ut ,të përcaktojë lëshimet në punë,posaqpërisht në fushën e finacave.

Kryesuesi tha se rekomandimet e përfaqësuesit të “Kthimit”, në esencë janë të njejta me ato të Komisionit parlamentar.Ai propozoi që rekomandimeve të Komisionit,në pikën 1 të

riformulohet me formimin e Komisionit ad hoc dhe të shtohet pika e 11.që kategoritë e rrezikuara sociale në Kosovë,të kenë lehtësira,kurse Qeveria në bashkëpunim me KEK-un,t'i formulojnë kriteret lidhur me to.

Kryesuesi i vuri në votim rekomandimet e Komisionit për Tregti dhe Industri dhe rezultati ishte,si vijon:

Për-----60,

Për rekomandimet e deputetit Oliver Ivanoviq,rezultai i votimit ishte si vijon:

Për-----26.

Kryesuesi konstatoi:Kuvendi i Kosovës i miratoi rekomandimet e Komisionit parlamentar lidhur me gjendjen në KEK.

3. Parashtrimi i pyetjeve.

3.1

Deputeti Alush Gashi i kishte parashtruar pyetje ministrit të Ministrisë së Shërbimeve Publike lidhur me hapjen e Web faqes së institucioneve të Kosovës dhe të adresave elektronike të deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Ministri Jakup Krasniqi u përgjigj gojarisht në pyetjen e prashtruar.

3.2

Deputeti Ismajl Kurteshi i kishte parashtruar pyetje ministrit të Ministrisë së Arsimit,Shkencës dhe të Teknologjisë lidhur me sjelljet e disa profesorëve në shkollat e mesme.

Ministri Rexhep Osmani u përgjigj gojarisht në pyetjen e parashtruar.

3.3

Deputeti Berat Luzha i kishte parashtruar pyetje ministrit të Ministrisë së Arsimit,Shencës dhe te Teknologjisë lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor në klasët e nënta.

Ministri Rexhep Osmani u përgjigj gojarisht në pyetjen e parashtruar.

Deputeti Berat Luzha tha se nuk është i kënaqur me përgjegjen e ministrit.

Përgjigjet e ministrave u janë bashkangjitur stenogramit të seancës.

4. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare që do të mbahet më 26.06.2003.

Kryesuesi për seancën e ardhshme plenare që do të mbahet më 26 qershor 2003, propozoi këtë

R E N D D I T E;

1. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për qasje në dokumentet zyrtare-2003/11;
2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Regjistrit të të drejtave në pronësinë e paluajtshme-2003/14;
3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për naftën dhe prodhimet e saj-2003/18;
4. Shqyrtimi i gjendjes së tërësishme në arsimin e Kosovës dhe
5. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për produktet dhe pajisjet medicinale-2003/17.

Kuvendi e miratoi rendin e ditës për seancën e ardhshme plenare.

Seanca përfundoi në orën 13:55 minuta.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik **Nexhat DACI**